

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me procesmbajtësen praktikante, Laureta Shala, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. H. nga Gjilani, të cilin e mbron avokati H. A., sipas autorizimit, për shkak të veprës penale, **Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, nga neni 410, par. 2, lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr. 130/16, të dt. 07.02.2016, e sipas Marrëveshjes për Pranimin e Fajsisë, të datës ... .11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 22.11.2016, bie dhe në prezencë të palëve mori dhe publikoi shpalli këtë :**

**A K T G J Y K I M**

*I akuzuari H. H., nga babai I., nëna N., e lindur C., i lindur më ... në Gj., ku edhe jeton, në rr. "...", i pa martuar, ..., me gjendje të mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,*

**Ë S H T Ë F A J T O R**

*Sepse, më dt. ... .2015, rreth orës ... min. në rr. "...” në Gjilan, me përdorimin e atëçastshëm të dhunës, e ka sulmuar personin zyrtar, policin J. R. në atë mënyrë që, në momentin që e ka parë të gjakosur babain e tij, I. H., nga hidhërimi, nga xhepi ka nxjerrë një shkrepëse dhe e ka hudhur në drejtim të personave prezentë, me ç’rast, e ka goditur në kokë zyrtarin policor, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, kështu që, i pandehuri, veprimet e tij i ka drejtuar kundër të mirës juridike, që konsiston në rrezikimin e integritetit trupor dhe autoritetit të zyrtarit në kryerjen e detyrave zyrtare,*

*-me çka ka kryer vepër penale **Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, nga neni 410, par. 2, lidhur me par.1 të KPRK-së, andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 3. 41, 46, 62, të KPRK-së dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-së,***

**E G J Y K O N**  
**ME DËNIM ME KUSHT**

*Me Dënim Burgu, në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë ) ditësh, me kusht për 1 (një) vit .*

*Në bazë të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, Dënimi i shqiptuar me burg me kusht, do t'i zëvendësohet në Dënim Gjore, në shumë prej 1000 (njëmijë) €*

*Obligohet i akuzuari që t'a paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) €, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.*

**A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP. nr. 130/2016, të datës 07.02.2016, kundër të akuzuarit H. H., për shkak të veprës penale , **Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, nga neni 410, par. 2, lidhur me par.1** të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.*

*Prokurori i Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, Ismet Ukshini, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur edhe autorizim nga Kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu Kryeprokurorin, të akuzuarin, mbrojtësin e tij dhe ky si prokuror e çështjes, andaj, kërkojnë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me PP.II. nr. .../2016, të dt. ....02.2016*

*Mbrojtësi me autorizim i të akuzuarit, av. H. A., deklaroi se mbetet pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjithashtu edhe ky kërkon nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje.*

*I akuzuari H. H., deklaroi se marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar në mënyrë vullnetare, i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht është konsultuar me mbrojtësin e tij, është përnduar për kryerjen e kësaj veprë penale, ndërsa nuk ka qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta*

*nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe ky kërkon nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje.*

*Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, se është penduar për veprën në fjalë, më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa, si rrethanë rënduese, peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë, me bindje se një dënim të tillë është në përputhshmërinë me shkallën e përgjegjësisë penale të të akzuarit, dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës, duke qenë e bindur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.*

*Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 231/16, më datë 22.11.2016**

*Procesmbajtësja praktikante,  
Laureta Shala,*

*Gjykatësja e vetme gjykuese  
Luljete Shabani*

***KËSHILLA JURIDIKE:*** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njejtës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.*